

*Ncore*

***Konventa e Institucioneve Europiane te  
Artsimit te Larte***

***Salamanka, 29-30 Mars, 2001***

***Konkluzione te punes tematike te grupeve***

***Nga Rapporteur, Prof. Dr. Konrad Osterwalder, Rektor, ETH  
Zurih***

Qellimi kryesor i Konventes se Salamankes ishte politik: institucionet e arsimit te larte kerkonin te formulonin ne menyre te qarte synimet dhe objektivat e tyre, parimet udheheqese, kerkesat kryesore dhe disa nga veshtiresite qe duhet te kapercihen ne rrugen drejt Fushes se Arsimit te Larte European.

Universitetet e Europes treguan se ato synojne te krijojne te ardhmen e tyre ne kontekstin e ri European. Ato shprehen qarte vullnetin e tyre, qellimin e tyre dhe vendosmerine e tyre per te marre persiper sfiden e Deklarates te Sorbonne/Bolonja dhe per te qene aktive ne procesin e ndertimit te Fushes Europiane te Arsimit te Larte deri ne 2010.

Ky dokument i shkurter - gjithashtu baze e Mesazhit te Salamankes per Ministrat Europiane te Arsimit te Larte ne takimin e tyre ne Prage ne 18-19 Maj 2001 - cakton rezultatet kryesore te punes se 12 grupeve te cilet gjate Konventes debatuan mbi gjashte tema te marra nga Deklarata e Bolonjes ne Qershor te vitit 1999.

#### 1. Liri me Pergjegjesi: fuqizimi i universiteteve

Universitetet kane nevojte per me shume liri ne se atyre u duhet te pershtaten shpejt me "ndryshimet mjedisore" dhe partneret e rinj lokale, kombetare dhe nderkombetare. Variacioni i detyrave te tyre te reja kerkon liri veprimi si rruge e vetme drejt me shume eficence. Universitetet duhet te jene ne gjendje te futen ne partneritete te reja, perfshire partneritetet me partnere komerciale, dhe ata duhet te jene ne gjendje te veprojne shpejt. Kjo kerkon nje lidhshperim te ri, kushte qe varen nga aftesia e institucioneve, fleksibilitet dhe pavaresi per te planifikuar strategjikisht.

Sidoqofte, universitetet nuk po kerkojne vetem me shume liri. Ato gjithashtu desherojne te pranojne pergjegjesine qe u takon: ato duan te jene te pergjegjshem per ate qe bejne dhe se si e perdorin lirin qe u jepet atyre.

#### ***Tema 1: Liri me pergjegjesi***

Universitetet si institucion legal ka nevojte per autonomi dhe duhet te jene te pergjegjshem per:

- Planifikim strategjik, percaktim i objektiveve dhe prioriteteve
- Alokim i fondeve
- Zgjedhja e partnereve mbi baze lokale, kombetare dhe nderkombetare, ne pune kerkimore dhe ne mesimdhenie
- Zgjedhja e fushave kerkimore
- Percaktimi i kurrikules
- Menaxhimi i kapitalit njerezor, punesimi i profesoreve ne vecanti
- Percaktimi i regullave te pranimit per studentet.

Besimi reciprok ne mes te qeverise dhe universiteteve mbi baze partneriteti eshte domozdoshmeri. Se fundi, por jo i parendesishem, edukimi i pavaresise intelektuale mbetet akoma detyre baze dhe kerkese e institucioneve akademike.

## **2. Punesimi ne tregun European te punes**

Programet e studimit duhet te jene akademisht te vlefshem dhe ne te njejten kohe ne perputhje me tregun e punes. Eshte domozdoshmeri fleksibiliteti ne kurrikul dhe ne kurset e studimit, ashtu si edhe diversiteti, duke respektuar talente te ndryshme dhe prespektivat e punesimit.

Prezantimi i ciklit te pare te programeve eshte i rendesishem per shkak te rritjes se numrit te studenteve. Percaktimi i programeve dhe gradave shkencore ne dy cikle kryesore eshte nje mundesi kuptimplote nese kurrikuli kujdeset per punesimin (ne lidhje me aftesite e zoteruara) si per studente qe transferohen ne punesim pas shkalles se pare shkencore dhe per ata qe veprojne ne kete menyre pas shkalles se dyte shkencore.

### ***Tema 2.***

Institucionet e Arsimit te Larte e konsiderojne punesimin e studenteve qe mbarojne univeritetin si nje objektiv te rendesishem dhe domozdoshmeri. Kjo kerkon fleksibilitet me te madh te programeve dhe zhvillim te koncepteve kurrikulare qe nxisin punesim gjate gjithë jetes dhe pershtatshmeri te studenteve. Per me teper kjo nenkupton diversitet dhe rritje te shumllojshmerise te pikave te futjes dhe daljes ne secilen nga eksperiencat e te mesuarit.

### ***Tema 3***

Punesimi ne nje kontekst universiteti do te thote:

- nje imagjinate e zhvilluar mire
- aftesia per perballur dhe zgjidhur nje problem sistematikisht dhe metodologjikisht duke zbatuar dije te permbatjes
- kapaciteti per te drejtuar proceset sociale

Struktura e pergjithshme e programeve te universitetit dhe çdo element duhet te drejtohet drejt zhvillimit te aftesive personale te siperpermendura, duke lejuar per nje shumllojshmeri te gjere te metodave kurrikulare dhe te kurseve kompetitive.

### ***Tema 4***

Institucionet e arsimit te larte duhet te kontribuojne ne transparence dhe njohje nepermjet te spjegimit te metodave te tyre kurrikulare dhe aftesive qe ato edukojne per nje menyre qe eshte kuptimplote per studentet, punojesit dhe te gjithë ata qe perfshihen. Me fjale te tjera, ato duhet te pergatisin studentet e tyre qe te perrballen me tregun e punes dhe rolin e tyre te ardhshem profesional (pergatitja per kerkim pune dhe menaxhimi i karrieres

personale) . Ne lidhje me partneret e tyre publik dhe private, ata duhet te krijojne qendrat e karrieres per qellime te tilla.

### ***3. Levizja ne fushen e Arsimit te Larte***

Levizja e studenteve dhe stafit nxit aftesine per t'u perballur me nje mjedis kulturor dhe mesimor dhe per te kuptuar kulturat e tjera. Ajo eshte nje kerkese ne kuadrin e globalizimit te sotem por gjithashtu promovon koherencen Europiane dhe pasuron kendveshtrimin shkencor.

Dy lloje te levizjes duhet te promovohen: levizja horizontale (d.m.th studenti qendron me nje universitet prites per nje ose dy semestra/vite dhe pastaj kthehet per te perfunduar nje grade shkencore ne nje institucion te vendit tij/saj. ) dhe levizje vertikale ( d.m.th studenti perfundon nje periudhe studimi ne nje institucion te pare dhe me pas leviz ne nje institucion te dyte per te vazhduar studimet e tij/saj dhe per te fituar nje grade shkencore; nje pike ideale per ndryshimin e institucioneve ne kete menyre eshte pas perfundimit te njerit prej cikleve).

Kushte te domozdoshme per levizjen jane:

- Kreditet ECTS perdoren si per shkembim dhe per akumulim;
- Diplome shtese;
- Nje metode me e gjere per njohjen e ceshtejve
- Mundesia si per levizje virtuale ashtu dhe per levizje fizike, e para nuk zevendeson te fundit;
- Mundesia e financimit per stafin dhe levizjen e studenteve;
- Sisteme transparente te sigurimit te cilesise ne te gjitha vendet dhe fushat lendore.

### ***Tema 5***

Levizja eshte nje vlere thelbesore e Fushes Europiane te Arsimit te Larte. Instrumenta ekzistues te njohjes duhet te zbatohen plotesisht:

- ECTS (zgjeruar ne akumulim dhe te mesuarit gjate gjithë jetes)
- Konventa e Lisbones
- Diplome shtese
- Rrjeti NARIC/ENIC

### ***Tema 6***

Levizja fizike duhet te nxitet si nje eksperience arsimore dhe nuk mund te zevendesohet nga nje levizje virtuale. Sidoqofte, eshte e nevojshme nje metode e perbashket Europiane ndaj levizjes virtuale. Benefitet (d.m.th. vlera e shtuar) shoqeruar me levizjen per staf, studente dhe kerkues shkencore duhet te publikohen. Me ne fund, barrierat administrative dhe strukturore dhe pengesat ndaj levizjeve duhet te hiqen. Palet e vendeve ne procesin e Bolonjes duhet te perkushtojne vetveten per heqjen e çdo ligji /regulli qe imponon

kerkesa kombetare te mbajtes te pozicioneve permananete dhe te perkohshme ne institucionet e arsimit te larte. Grante dhe hua portabel duhet te behen te mundshem per studentet, sebashku me nxitje te pershtatshme si per individed ashtu dhe institucionet.

### ***Tema 7***

Krijimi dhe zhvillimi i Fushes Europiane te Arsimit te Larte varet nga njohja e rolit esencial te insitucioneve te arsimit. Ato jane nje force shtytese ne te gjithë procesin. Politika e tyre e qarte e nderkombetarizimit duhet te mbaje parasysh:

- Rendesine thelbesore te stafit mesimdhenes me eksperience nderkombetare
- Sigurimi i gjuhes realiste (kjo kerkon heqjen e çdo ligji /rregulli qe pengon mesimdhenien ne gjuhe te huaj) dhe sigurimin e kurseve te caktuara ne gjuhe qe fliten gjersisht.
- Nevoja per t'u ofruar te gjithë studenteve ne arsimin universitar, pavaresisht nga fusha e e specializimit te tyre, mundesine per te marre nje numer kreditesh ne gjuhe te huaj;
- Cilesi e mire, perdorimi-miqesor i informacionit nga studentet lidhur me mundesi nderkombetare.

### **4. Pershtatja: kornize kualifikimi e perbashket por fleksibel**

### ***Tema 8***

Arsimi i Larte duhet te strukturohet ne menyre te tille qe pas 3-4 vjet ( ose me mire 180-240 ECTS kredite ) nje student duhet te jete i afte per nje shkalle shkencore te tipit Bachelor. Kjo grade shkencore duhet ose te çoje ne punesim imediat ose te siguroje pergatitjen per studime te metejshme qe çojne drejt grades shkencore Master. Ne rrethana te caktuara nje universitet mund te vendose te strukturoje nje kurrikul si nje program 5 vjeçar te integruar (d.m.th. e pathyer ) qe çon direkt ne ne nje grade shkencore te nivelit Master. Rrjete profesionale dhe disiplnore kane nje rol te rendesishem ne informimin e vendimeve te tilla.

### ***Tema 9:***

ECTS duhet te perdoret nga universitetet jo vetem per transferimin e krediteve por edhe per akumulim krediti:

- Nepermjet dhenies se krediteve per vleresimin e te mesuarit te fituar brenda dhe jashte universitetit
- Vartesi ndaj kerkesave te profesioneve te percaktuara dhe e drejta e universiteteve per te vendosur ne se kreditet e fituara jashte jane apo jo te pranueshme.

Sigurimi i cilesise eshte nje pjese esenciale e ketij procesi.

5. Sigurimi i cilesise dhe çertifikimi i cilesise

## ***Tema 10.***

Nderkombetarizimi i sigurimit të cilësive është një përgjigje e domozdoshme ndaj rrymave të globalizimit aktual dhe ndaj sfidave të ndertimit të një Fushe të Arsimit të Lartë Europian. Akreditimi është një përgjigje ndaj këtyre sfidave dhe mekanizmat e sigurimit të cilësive janë domozdoshmeri për procedurën e mira akreditimi.

Një lloj platforme Europiane apo sistemi pastrues ka nevojë të organizohet me mbështetje të plote të institucioneve të arsimit të lartë me qëllim përhapjen e praktikave të mira dhe keshillim për organizma akreditues mbi procedurën e pershtatshme. Ajo duhet të nxisë pranim të përbashkët të vendimeve të sigurimit të cilësive ndërsa ruajnë ndryshimet kombëtare dhe lëndore dhe autonominë institucionale dhe jo mbingarkesën e universiteteve. Ky rol i ENQA në këtë proces duhet të mbahet në konsideratë.

### ***6. Konkurenca në vend dhe në botë***

Konkurenca në cilësi dhe prandaj është e mirë për studentët. Por universitetet kanë nevojë për më shumë liri operacionale dhe një skemë financiare të drejtë për të ardhurën në konkurim real. Me shumë diversitet të kurrikulës do të çojë më tej konkurimin. Me shumë konkurrenca nevojitet për të tërhequr studentët përtej kontinentit. Konkurenca dhe kooperimi nuk janë bashkërisht të përjashtues. Konkurenca nënkupton se pari, cilësi akademike dhe nuk mund të reduktohet vetëm në një koncept komercial.

Europa ka nevojë të jetë në një pozicion që të jetë në gjendje të tërheqë trurin më të mirë nga e gjithë bota por kjo kërkon lëvizje të shpejta të imigrimit të papershtatshëm dhe rregullave të tregut të punës.

Konkurenca ngre çështje brenda Europës (Lindja kundrejt Perëndimit, Jugu kundrejt Veriut) dhe ekziston rreziku i një largimi të trurit nga brenda - Europës. Masa specifike mund të jenë:

- Prezantimi i programeve të studimit të mesuara në gjuhët kryesore të botës;
- Më shumë marketing në vendet jo-Europiane, nëpërmjet të zhvillimit të markave tregëtare dhe tipeve të produkteve arsimore;
- Zhvillimi i shërbimeve të pershtatshme për studentët dhe shkollaret e huaj duke lejuar institucionet e Arsimit të Lartë Europian të konsiderohen si institucione mikpritëse;
- Konkurenca me kontinentet e tjera përmes rrjeteve strategjike.

## ***Tema 11***

Institucionet e arsimit të lartë desherojnë të marrin përgjegjësi të operimit në një fushë të arsimit kompetitiv, por kjo kërkon më shumë autonomi menaxheriale (që shkon tej lirise akademike klasike), një kornizë rregulluese fleksibël dhe financim të drejtë.

## ***Tema 12***

Konkurenca i shërben cilesise se arsimit dhe eshte e mire per studentet, institucionet e arsimit te larte dhe bashkepunetoret e tjere. Ajo duhet te pranohet dhe te nxitet dhe ne te njejten kohe te mbeshtet nga sigurimi i nje cilesie te qendrueshme dhe mekanizma akredituese qe jane te lexueshme brenda dhe jashte Europes.

## ***Tema 13***

Te qenit me kompetitiv gjithashtu kerkon me shume hapje, transparence dhe konkurrence ne vend. Ai kerkon nje rishikim te sherbimeve tona dhe kultures se tregut ne lidhje me realitetet dhe vlerat e Arsimit te Larte European te tilla si diversiteti, orientimi punes kerkimore dhe pergjegjesia sociale. Universitet ne vende te caktuara nuk jane ende te pajisur per te konkuruar mbi baza te barabarta dhe kane nevojte per ndihmes te vecante.

## ***Konkluzione***

Universitet European dhe organizatat e tyre desherojne dhe jane ne gjendje te udheheqin perpjekjet e perbashketa:

- Te rinovojne dhe rigjallerojne arsimin e larte;
- Ta ripercaktojne ate ne shkalle European ;
- Te nxisin punesimin e studenteve qe kane perfunduar studimet dhe dhe levizjen e studenteve dhe stafit te tyre;
- Te shtyjne perpara pershtatjen midis institucioneve dhe kurrikulave;
- Te sigurojne cilesi ne Fushen European te Arsimit te Larte;
- Te jene me konkures, duke mos perjashtuar bashkepunimin;
- Te adresojne veshtiresi specifike te universiteteve ne pjese te ndryshme te Europes.

Kerkese e domozdoshme jane liria dhe fonde te pershtatshme, ashtu si edhe heqja e imigrimit dhe kufizimeve te tregut te punes.

Institucionet e Arsimit te Larte European desherjne te jene ne nje pozicion qe te formojne te ardhmen e tyre ne Fushen Arsimore te Arsimit te Larte European. Ne se te gjitha e desherojne kete gje, mesazhi i tyre do te degjohet dhe kjo gje do te ndodhe.

---

**Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.**